



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada -Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas(Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-11799 Dt. 02/09/2026

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr 03/L-040, nenit 17 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, nenit 7 dhe 12 të Rregullores MF – nr. - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullores me nr 320-10338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, Kryetari i Komunës së Drenasit, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes Publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

I

1.Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF – nr – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Rregullores me nr.320-10338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve.

2.Mbështetja publike për projektet/programet e organizatave joqeveritare dhe personave fizik do të sigurohet nga Programi Kultura, Rinia dhe Sporti të Komunës së Drenasit në kuadër të Nënprogrami Shërbimet Kulturore dhe Kategoria Ekonomike Subvencione dhe Transfere.

II

Mjetet e përmendura në nenin 1 të Vendimit do të shpërndahen në bazë të Thirrjes Publike për financimin e projektit, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes, sipas nenit II të këtij vendimi, përfshinë:

- 1.1 Teksti i thirrjes publike
- 1.2 Udhëzimet për aplikantët
- 1.3 Formularët e aplikimit

2. Formularët e aplikimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 1.Formularin e përshkrimit të programit ose projektit(F1)
- 2.Formularin e buxhetit të programit ose projektit (F2)

Handwritten signature

3. Formularin e deklaramit të mungesës së financimit të dyfishtë të aktiviteteve nga një burim tjetër (F3)
4. Deklaratën e partneritetit (nëse zbatohet - F4)
5. Formularin e deklaramit të programeve dhe projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (F5)
6. Deklaratën për aktivitetet e kontraktorit të përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur e programin ose projektin (F6)
7. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin (F7)
8. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit (F8)
9. Formulari – aplikacioni për projektet për individ/persona fizik

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen dhe mund të shkarkohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Drenasit komuna.drenas@rks-gov.net

V

Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të. Komuna e Drenasit do ta themelojë Komisionin vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

Komisioni vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren MF-nr.04/2017 për financimin publik të OJQ-ve, Rregullores me nr.320-10338 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve

VI

Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve ose të personave fizik.

Komuna e Drenasit do të njoftojë përfituesin për kohën e nënshkrimit të kontratës.

Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

VII

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës



Ramiz Lladrovci